

Njoftim i përqendrimit me të cilin SHOQËRIA Aksionare SARANTIS POLSKA nga Polonia do të fitojë kontroll individuale mbi Shoqërinë Me Përgjegjësi Të Kufizuar STELLA PEK JUROP nga Polonia

(lënda nr. 08-69 e vitit 2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë "nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më datë 29.03.2022, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës dorëzohet një njoftim për përqendrim i cili i referohet fitimit të kontrollit individual nga SHOQËRIA Aksionare SARANTIS POLSKA nga Polonia, me seli të regjistruar në rr. "Pulavska" nr. 42 C, 05-500 Pjasečno, Poloni, mbi Shoqërinë Me Përgjegjësi Të Kufizuar STELLA PEK JUROP nga Polonia, me seli në rr. "Zadumana", nr. 11A/4. 02-206 Varshavë, Poloni dhe 40% të aksioneve në Shoqërinë Aksionare Stella Pek me seli në Lubartov, Poloni. Transaksioni përfshin gjithashtu blerjen e kontrollit indirekt mbi filialet e Stella Pak në Rumani dhe Ukrainë.

SHOQËRIA Aksionare SARANTIS POLSKA është shoqëri aksionare në pronësi private të Polonisë, një filial në pronësi të drejtpërdrejtë të plotë të GR. Sarantis S.A. me seli në Amarusion, Greqi. GR Sarantis është një subjekt e cila kuoton në bursën e Athinës që nga viti 1994 dhe është një kompani mëmë e Grupit Sarantis. Grupi SARANTIS kontrollon degët operative në dhjetë vende evropiane - Poloni, Rumani, Bullgari, Serbi, Republikën Çeke, Hungari, Maqedoninë e Veriut, Bosnjë, Sllovaki dhe Portugali - ndërkohë që mbetet e pranishme ndërkombëtarisht dhe udhëheq një rrjet shpërndarjeje përmes të cilit eksporton në më shumë se 35 vende.

Grupi SARANTIS ka një person të lidhur të regjistruar në Maqedoninë e Veriut-Sarantis Skopje SHPKNJP, Shkup me seli në Bul. „8mi Septemvri“ 40/2, Shkup.

Shoqëria Me Përgjegjësi Të Kufizuar STELLA PEK JUROP është një kompani holding e kontrolluar nga Grupi Baunti Brends. Shoqëria Me Përgjegjësi Të Kufizuar STELLA PEK JUROP zotëron shumicën e aksioneve (60%) në Stella Pak - një shoqëri aksionare në të cilën Forum 87 Fundusz Inwestyci Zamknięty ka 40% të pjesëve. Stella Pak është një nga prodhuesit më të mëdhenj të qeseve të mbeturinave dhe shpërndarësit e produkteve jo-kimike të pastrimit dhe higjienës në Evropë. Shoqëria ka një përvojë 20 vjeçare në prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve të cilësisë më të lartë dhe në ndërtimin e pozicionit të markave të veta në treg.

Përveç Stella Pak, Grupi përfshin Stella Pak Ukraina dhe Stella Pak Romania ("**Grupi Stella**") (**Stella Group**). Ai është aktiv në 33 vende dhe eksportet përbëjnë rreth 44% të shitjeve (2019). Në vitin 2021, numri i punonjësve në Grupin Stella ishte më shumë se 800 persona.

Grupi Stella nuk ka shoqëritë lidhura në Maqedoninë e Veriut dhe ka fituar vetëm të ardhura minimale.

13.04.2022

Shkup